

**STATUT DHE AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“ËNDËRRO PRODUCTIONS”**

**Kreu I**  
**DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Forma ligjore dhe emri i shoqërisë**

“ËNDËRRO PRODUCTIONS” SH.P.K. është themeluar bazuar në ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, si dhe në Aktin e Themelimit të Shoqërisë, nënshkruar nga Ortakët.

“ËNDËRRO PRODUCTIONS” SH.P.K. është themeluar dhe funksionon si shoqëri tregtare e formës “me përgjegjësi të kufizuar” (sh.p.k.). Nga këtu e më poshtë në këtë statut shoqëria “ËNDËRRO PRODUCTIONS” SH.P.K. do referohet shkurtimisht si shoqëria.

Shoqëria fiton personalitetin juridik si dhe të drejtën për të kryer veprime dhe të marrë përsipër të drejta dhe detyrime gjatë aktivitetit të saj të përditshëm , që nga data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Shoqëria e realizon aktivitetin e saj, sipas objektit të përcaktuar në këtë statut, bazuar në legjislacionin shqiptar, Statutin dhe Aktin e Themelimit.

**Neni 2**  
**Ortakët e shoqërisë**

Shoqëria është themeluar nga ortaku:

- Elvis Peçi atësia Aleksandër, i datëlindjes 26/03/1982, i lindur në Tiranë dhe banues në *Bulevardi "Gjergj Fishta", kulla e bardhe 2, Tiranë 1001*, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i indentifikuar nga karta identitetit me nr. I20326075I.

**Neni 3**  
**Kohezgjatja**

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit, me afat të pakufizuar, e cila fillon nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar. Afati mund të shkurtohet apo zgjatet me vendim të ortakëve, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga ky Statut.

**Neni 4**  
**Selia**

Selia e Shoqërisë “ËNDËRRO PRODUCTIONS” SH.P.K. do të jetë në *Bulevardi "Gjergj Fishta", kulla e bardhe 2, Tiranë 1001*. Shoqëria mund të vendosë të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj.



## Neni 5 Objekti i aktivitetit

Objekti i aktivitetit të shoqërisë **“ËNDËRRO PRODUCTIONS” SH.P.K.** do të jetë:  
Prodhime dhe shpërndarje e materialeve audiovizuale dhe multimediale. Prodhime/produksione të filmave me metrazh të gjatë, filmave muzikorë (mjuzikëll), shfaqjeve të teatrit muzikor (mjuzikëll), festivaleve, trajnimeve artistike në formën e programeve televizive, filmave të shkurtër, seriale dhe telenovela televizive apo online (webseries), dokumentarë, filma publicitarë dhe spote, filma me animacion 2D, 3D, stop motion etj., video promovuese, reportazhe, programe televizivë, videolojra (videogames), aplikacione për telefona smart ose tv smart, reklama, spote televizive, video muzikore, sigla, etj. Realizim dhe publikim i produkteve audio - video për media sociale, shërbime streaming. Krijimi dhe kurimi i kanaleve radio televizive online (youtube, rrjete sociale, etj) që transmetojne livestream ose të regjistruara materialet ne platformat digitale. PR, Konsulencë, Menaxhim, Komunikim, Marketing, Produkte Reklamimi, Përzgjedhje aktorësh/performuesish (Casting), Kërkime dhe Studime tregu, Planifikime, Krijimtari, Organizim dhe Realizim i strategjive, dizajn dhe mirëmbajtje e faqeve të internetit brenda fushave të saj. Organizim i eventeve artistike, kulturore, argëtuese, edukuese, sociale, shoqërore dhe familjare. Projektim i hapësirave të reja performuese dhe menaxhim te hapësirave ekzistuese si: salla koncertesh klasike apo alternative, teatro, galeri arti, muzeume, duke stimuluar një krijimtari inovative dhe ndërdisiplinore. Stimulim i programeve të artistëve në rezidencë, duke përfshirë kurse, krijimtari të re, workshop-e në degë të ndryshme artistike (përfshirë muzikën, artet pamore, letërsinë, filmin, teatrin, dizajnin, arkitekturën etj). Realizim projektesh arkitekturore rekreative (përfshirë mobilime dhe arredime) në qendrat urbane dhe rurale. Produkte mode, përfshirë artizanatin dhe manifakturën. Si prodhim, distribucion dhe shitje. Zhvillim i industrisë krijuese dhe industrisë së Dijes dhe Edukimit. Trajnime Profesionale për moshë të ndryshme, didaktike, edukuese, për fëmijë, adoleshentë dhe deri në studime universitare, përfshirë akordimin e certifikatave dhe trofeve për kurse dhe çmime nga profesionistë të fushave të artit, muzikës, teatrit, filmit, dhe degëve të tjera të industrisë krijuese. Kërkime për llogari të aktivitetit të saj ose të shoqatave ose edhe të institucioneve publike. Kërkime dhe aplikime ne fushen e Inovacionit, transferim i dijeve dhe teknologjive. Konceptimi, krijimi dhe menaxhinimi i bazave të të dhënave në fushën e industrisë krijuese. Politika mbi përfshirjen e inteligjencës artificiale dhe teknologjisë smart në fusha të ndryshme në lidhje me aktivitetin e saj. Platforma online përfshirë hapësira bashkëpunimi dixhital. Stimulim e mbështetje për projektet e reja (startup-e) me karakter zhvillues dhe fitimprurës brenda fushave të saj. Nxitje e mbështetjes përmes crowdfunding të produkteve artistike. Prodhim Produktesh Audio - Vizive dhe shërbimesh të industrisë krijuese dhe jo vetëm, përfshirë distribucion/shpërndarje, logjistikë, magazinim, tregëtim, shitje, import-eksport, organizim eventesh dhe aktivitetesh, organizim fushatash, këshillim dhe menaxhim projektesh, promovime, studime, financime, trajnime, edukime, rritje kapacitetesh në fushat e saj, shkëmbime kombëtare dhe ndërkombëtare, etj. Organizimi i koncerteve apo spektakleve të ndryshëm, si organizator, producent apo si bashkëorganizator, me mbështetje nga institucione kombëtare apo ndërkombëtare, shtetërore ose private. Prodhimi dhe shitja e spoteve publicitare. Prodhimi dhe shitja e klipeve, videoklipeve të ndryshme; Prodhime dhe bashkëprodhime të ndryshme televizive dhe kinematografike. Hapja dhe menaxhimi i shkollave dhe i kurseve të ndryshme të muzikës, artit skenik, këndimit, regjisurës, aktrimit, kamerës, fotografisë, dhe degëve të tjerë pjesë e industrisë krijuese (përfshirë ato menaxheriale), gjithashtu trajnim i fotomodeleve dhe modeleve, prezantueseve, moderatoreve etj. Hapja dhe menaxhimi i agjencive të ndryshme për përzgjedhje dhe trajnim (casting) për aktorë, këngëtarë, fotomodelë; Organizimi dhe menaxhimi i sfilatave të ndryshme të modës. Botime të ndryshme të përqëndruara në fushat e artit, artit skenik, muzikës, kinematografisë dhe industrisë krijuese; Prodhimi dhe shitja e banerave,

4. 7.

posterave, fletepalosjeve dhe billboard te ndryshme LED. Organizimi dhe menaxhimi i veprimtarive të ndryshme kushtuar ngjarjeve historike, kulturore, artistike por edhe sportive brenda dhe jashtë vendit. Krijim, tregtim dhe instalimin me materiale te ndryshme të skenografive, props, dhe elemente të ndryshme dekorative për shfaqje artistike, spektakle, konkurse, instalacione, teatro, mjuzikëlle, filma, si dhe çdo veprimtari tjetër të nevojshme për realizimin e qëllimit të shoqërisë që nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar në fuqi

## **Kreu II KAPITALI DHE KUOTAT Neni 6**

### **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare “**ËNDËRRO PRODUCTIONS**” SH.P.K. është 10.000 (dhjetëmijë) Lekë.

Kapitali themeltar është i ndarë në 1 (nje) kuotë, me vlerë 10.000 lekë.

– Z.Elvis Peçi me 10.000 lekë (100%).

## **Neni 7 Regjistri i kuotave të kapitalit themeltar**

Kuotat dhe zotëruesi i tyre, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me kuotat e kapitalit themeltar, regjistrohen në një regjistër të posaçëm.

1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
  - a)kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b) shit - blerjes;
  - c) trashëgimisë;
  - ç) dhurimit;
  - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.
3. Statuti mund të kushtëzojë kalimin e kuotave, veçanërisht duke përcaktuar miratimin e shoqërisë ose të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë.
4. Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata për kalimin e kuotës hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakord në kontratë, vlefshmëria e kalimit tëtitullit të pronësisë mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit.

## **KREU III**

### **Të drejtat dhe detyrat e Ortakëve:**

## **Neni 8**

4. 7. -

### **Ortakët gëzojnë këto të drejta kryesore**

- Pjesëmarrjen në rezultatet e cdo forme dhe sasi të veprimtarisë së shoqërisë e parashikuar në kontratën dhe statutin e saj. Marrjen e të gjitha të dhënave që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike tregtare dhe veprimtarinë e shoqërisë, si dhe me të gjithë dokumentat e përpunuara nga shoqëria, bilancet si dhe llogaritë ekonomike, etj.
- Paraqitjen e propozimeve dhe shqyrtimin e tyre nga mbledhja e përgjithshme e Asamblesë dhe organet e tjera të shoqërisë.
- Të heqë dorë nga shoqëria.
- Heqja dorë nga shoqëria nuk i liron ortakët nga detyrimet financiare të marra më parë ndaj shoqërisë.
- Të marri pjesë në organet e shoqërisë që janë ose mund të krijohen nëpërmjet përfaqesuesit të tij ose vetë.
- Të kërkojë ti jepen të gjitha informatat që kanë të bëjnë me gjendjen prodhuese dhe tregtare të shoqërisë, si dhe të gjithë dokumentat e përpunuara të shoqërisë, si bilancet, llogaritë ekonomike, etj.
- Të emërojë dhe të shkarkojnë përfaqesuesit e saj, punonjësit, ekspertin kontabël dhe likuidatorët.

### **Neni 9**

#### **Ortakët kanë këto detyrime kryesore**

- Të depozitojë kuotën e tij dhe kuotën suplementare në përputhje me kontratën dhe statutin.
- Të marri pjesë në administrimin e shoqërisë nëpërmjet organeve të krijuara nga vetë ai.
- Ti japë Shoqërisë të dhënat e domosdoshme për përpunimin e cdo objekti të vecantë lidhur me veprimtarinë e saj.
- Të kryejë detyrat për realizimin e objektivave dhe të funksioneve të shoqërisë.
- Ortakët kanë të drejtë të heqin dorë nga shoqëria duke i njoftuar vendimin e tij asamblesë 6 muaj përpara dhe duke ceduar të drejtën e zgjedhjes sipas nenit.
- Heqja dorë nga shoqëria nuk i liron ortakët nga detyrimet financiare të marra më parë ndaj shoqërisë.
- Ti japi shoqërisë informatat e nevojshme që kanë të bëjnë me ecurinë e veprimtarisë së saj.
- Të kryejë shërbimet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe realizimin e funksioneve të saj.
- Pjesëmarrja në shoqëri nuk i pengon ortakët të kenë pavarësi ligjore për veprimtari të tjera dhe për të drejta të tjera pronësie. Ai nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë që rrjedhin nga objekti i veprimtarisë së saj të kapitalit themelor ku ata kanë marrë pjesë.

## **KREU IV**

### **Kushtet Ekonomike**

#### **Neni 10**

Veprimtaria e shoqërisë realizohet në bazë të leverdisë ekonomike dhe pasqyrohet në bilancet e saj. Bilanci vjetor i shoqërisë nxirret brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës. Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor.

#### **Neni 11**

*9. 2*

Llogaritë vjetore, inventari, raportet, operacionet e veprimtarisë së vitit financiar dhe raportet e vecanta të hartuara nga administratori dhe eventualisht nga eksperti kontabël i autorizuar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

#### **Neni 12**

Për të bërë të mundur zhvillimin e veprimtarisë së shoqërisë, vihet një kapital bazë që përbën burimin fillestar për krijimin e fondit themelor dhe të mjeteve të xhiros.

#### **Neni 13**

Kur Shoqëria pushon veprimtarinë e saj, pasi shlyen të gjitha detyrimet që ka, pjesën e mbetur të kapitalit dhe të ardhurave i marrin ortakët themelues.

Fitimi neto i realizuar nga shoqëria, pasi zbriten të gjitha detyrimet si edhe fondet e lëna rezervë për nxitjen ekonomike, për investimet, për reklamën tregtare etj.përfitohen prej ortakëve themelues të kësaj shoqërie.

Ortakët përballojnë humbjet e shoqërisë deri në kufirin e vlerës së tyre të derdhur në formimin e kapitalit themeltar.Në rast zmadhimi të kapitalit themeltar nëpërmjet shtimit të tij ortakët kanë të drejtën e rritjes së tij.

Pjesët e kapitalit themeltar janë plotësisht të transferueshme në rrugë trashëgimie në rast ndarjeje pasurie ndërmjet bashkëshortëve dhe nëpërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar duhet të vërtetohet me akt noterial.

Shoqëria në emër të vet është pronare, përdoruse dhe disponuse e pasurive të saj, por gjithmonë në përputhje me qëllimin e objektin e veprimtarisë që ajo kryen.

Shoqëria mund të shesë pasuri ose të shfrytëzojë të drejta të tjera materiale. Ajo mund të ofrojë për garanci edhe pasuri të saj për të marrë kredi bankare.

Shoqëria krijon fonde rezervë ose dhe fonde të tjera të vecanta për zhvillimin dhe nxitjen ekonomike të saj.

#### **Neni 14**

Shoqëria është pronare e pasurive të saj dhe ka të drejtë të përdorimit dhe disponimit të kësaj pasurie,në përputhje me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë që kryen. Shoqëria gëzon të drejtat për mbrojtjen e pasurisë së saj në përputhje me Legjislacionin Shqiptar.

#### **Neni 15**

E ardhura bruto e shoqërisë, pasi zbritet amortizimi i të gjithë pasurisë së lujtshme e të palujtshme,sipas afateve të caktuara, kuotat që kanë të bëjnë me kreditë për investimet,pagat e shtesat mbi pagat,shpenzimet për lëndët e para apo ndihmëse e energjinë si dhe shpenzimet e përgjithshme të saksioneve të shoqërisë dhe ato për qëllime të tjera prodhuese e joprodhuese, i takojnë ortakëve të shoqërisë.

**Kreu V**  
**Administrimi**  
**Neni 16**

**Organi vendimtar i shoqërise është Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.**

Shoqëria do të administrohet nga Z. Elvis Peçi sipas statutit dhe ligjit për një periudhë 5-vjecare me të drejtë ripërtëritje.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorët në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Përveç kësaj, administratorët shkarkohen nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Administrator i shoqërisë mund të emërohet edhe një person jashtë ortakërisë.

**Neni 17**

Për çështjet që vijojnë Asambleja e Ortakëve merr vendime eskluzive:

1. Përcaktimi i të drejtave kryesore të veprimtarisë së shoqërisë.
2. Ndryshime në emërtesën e projekteve që do të realizohet dhe të punimeve që do të kryhen, që janë pjesë përbërëse e objektit të veprimtarisë së shoqërisë.
3. Propozimet e nevojshme për ndryshimet në kapitalin bazë të shoqërisë.
4. Përcaktimi i regjimit dhe i kushteve të zbatimit të parimeve të llogarisë ekonomike.
5. Përcaktimi i rregullave dhe i normave, që përkufizon raportet me gjirin e shoqërisë duke përfshirë edhe kuadrin e personelit.
6. Përcaktimi i strukturës së aparatit të shoqërisë.
7. Përcaktimi i organikës dhe ndarja e vendeve drejtuese ndërmjet përfaqësive të ortakëve.
8. Emërtimi dhe zëvendësimi i administratorit të përgjithshëm të shoqërisë.
9. Krijimi i organeve të tjera të domosdoshme për realizimin e objektivave të shoqërisë.
10. Përcaktimi i madhësisë të kuotave për formimin e kapitalit bazë të shoqërisë.
11. Paraqitja e propozimeve për rregullimin, krijimin dhe përfitimin nga fondet e veçanta, ndarja e fitimeve dhe përcaktimi i rregullave për shlyerjen e borxheve.
12. Marrja e vendimeve për krijimin e filjaleve të degëve dhe të përfaqësive si dhe për çedimin e veprimtarisë së tyre.
13. Përcaktimi i rregulloreve për procedurën e punës të administratës.
14. Përgatitja e propozimit për pushimin e veprimtarisë së shoqërisë.
15. Përzgjedhja e antarëve për komisionin e likuidimit të cilët emërohen dhe rivokohen nga asambleja e ortakëve.
16. Kryerjen e veprimtarive për likuidimin e llogarive, që i përkasin ortakëve dorëhequr të shoqërisë.
17. Marrja e vendimit për kërkimin dhe përdorimin e kredive afatgjata.

## Neni 18

Veprimtaria operative e shoqërisë drejtohet nga **Administratori** i saj. Në shoqërinë “**ËNDËRRO PRODUCTIONS**” SH.P.K. administratori i shoqërisë do të jetë: Z. Elvis Peçi, i cili në të njëjtën kohë ka dhe funksionin e përfaqësimit të shoqërisë me të tretët në gjithë veprimtarinë së saj. Me miratimin e ortakëve mund të emërohen administratorë dhe përfaqësues të shoqërisë “**ËNDËRRO PRODUCTIONS**” SH.P.K.

Administratori emërohet për një kohëzgjatje prej **pesë vjetësh** financiare me përjashtim të rasteve të dorëheqjes ose shkarkimit të përkohshëm. Administratori ka të gjitha kompetencat për të kryer të gjitha veprimet me interes të shoqërisë dhe në emër të saj nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e veprimtarisë së shoqërisë me përjashtim të atyre kompetencave që ligji nuk i njeh. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë apo të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të statusit apo për faj të tij gjatë administrimit të shoqërisë.

### **Kompetencat e administratorit në shoqëri janë:**

Të miratojë planet e llogarive ekonomike pas përpunimit të tyre në kuadrin e veprimtarisë së shoqërisë.

- Të bëjë propozimet në mbledhjen e asamblesë kur lind nevoja e kapitalit themeltar të shoqërisë.
- Të miratojë akt normative që përcaktojnë raportet në shoqëri duke përfshirë kuadrin dhe personelin.
- Të përcaktoj strukturën e aparatit të shoqërisë.
- Të krijojë organe të tjera të domosdoshme për realizimin e objektivave të shoqërisë.
- Të propozojë në mbledhjen e asamblesë për krijimin e njësive, strukturave si filjale, degë e përfaqësi në qytete të tjera të vendit ose jashtë shtetit.
- Të përgatisi propozimet për pushimin e veprimtarisë së shoqërisë dhe t'ia paraqesin ato Asamblesë për miratim.
- Të përzgjedhi ekspertet kontabël dhe antarët e komisionit të likuidimit dhe të paraqesin propozimet për miratimin në asamble.
- Të sigurojë zbatimin e përpiktë të vendimeve të asamblesë.
- Të përcaktojë numrin e punonjësve të shoqërisë dhe pagat e tyre.
- Organizon punën për realizimin e planeve të shoqërisë dhe raporton për to në përputhje me programet e planet e përgjithshme, administron pasurinë e shoqërisë, duke përfshirë këtu mjetet financiare, brenda caqeve të vendimeve të marra nga organi administrative i shoqërisë.
- Drejton e kontrollon veprimtarinë e filialeve të degëve e të përfaqësive.
- Përfaqëson shoqërinë përpara të tretëve si gjykatë etj.
- Nënshkruan kontrata në emër e për llogari të shoqërisë dhe siguron vënien e tyre në jetë.
- Merr të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me ato veprimtari të shoqërisë, që nuk janë në kompetencë ekzekutive të Asamblesë së Ortakëve.
- Raporton dhe i përgjigjet asamblesë për zbatimin e veprimtarive të shoqërisë si dhe për realizimin e objekteve dhe detyrave që janë në kompetencë të tij.
- Siguron drejtimin e shoqërisë.
- Përfaqëson shoqërinë në lidhje me të tretët brenda caqeve të objektit dhe të veprimtarisë së saj, përveç çështjeve që kërkojnë unanimitetin e ortakëve ose që kanë të bëjnë me kompetencat që ky statut i atribuon asamblesë së ortakëve.
- Organizon zbatimin e saktë të vendimeve të asamblesë së ortakëve.

## Neni 19

Për të kontrolluar veprimtarinë financiare të shoqërisë e të filialeve të saj krijohet komisioni i revizionimit kontabël.

Kryetari dhe anëtarët e këtij komisioni emërohen nga Asambleja e Ortakëve Kryetari i komisionit emërohet për cdo mandat nga Asambleja.

Komisioni i Revizionimit kontabël përbëhet nga 3-5 vetë dhe qëndron në detyrë për një periudhë prej tre vjetësh.

Kryetarin dhe anëtarët e komisionit nuk mund të jenë në varësi të shoqërisë ose filialeve të saj.

Komisioni i Revizionimit kontabël është përgjegjës për veprimtarinë e vet para Asamblesë së Ortakëve dhe është i detyruar ti paraqesë asaj cdo vit raport për kontrollet e bëra si dhe konkluzionet për bilanci vjetore.

## Neni 20

### Marrëdhëniet e punës në shoqëri

Marrëdhëniet e punës në shoqëri e filiale në degë e përfaqësitë rregullohen në përputhje me vendimin për krijimin e shoqërisë, legjislacionit shqiptar dhe me këtë statut si dhe nëpërmjet kontratës së punës. Për çështjen që nuk rregullohen në kontratën e punës, zbatohen dispozitat e legjislacionit të punës. Punësimi i punonjësve në shoqëri bëhet mbi bazën e kontratës individuale të punës.

Në kontratën e punës rregullohen këto çështje:

- Kushtet dhe mënyra e marrëdhënies së punës.
- Fillimi i punës së punonjësve dhe caktimi i tij në vendin e punës.
- Koha e punës dhe caktimi i kohës së punës, puna e natës, puna jashtë kohës normale, puna në ditët e pushimit javor, festive zyrtare.
- Mbrojtja në punë dhe kushtet e punës.
- Pushimet dhe mungesat, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e Punonjësve për zbatimin e detyrave të punës.
- Pushimi i marrëdhënies së punës.
- Paga e punës së punonjësit, shpërblimi i punës dhe shpërblimet e tjera.
- Shoqëria merr përsipër të bëjë sigurimin e të punësuarve pranë saj në organet përkatëse duke derdhur rregullisht kontributet në përqindje të caktuara sipas dispozitave ligjore në fuqi.
- Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, organi kompetent për shqyrtimin e tyre është Gjykata e rrethit Gjyqësor, Tiranë.

## KREU VI

### Mbyllja e shoqërisë

#### Neni 21

Veprimtaria e shoqërisë pushon me propozimin e ortakëve, kur gjatë dy vjetëve nuk rezulton rentabël ose kur ortakët heqin dorë nga shoqëria si dhe të gjitha rastet që parashikohen në dokumentet e krijimit të shoqërisë (kontrata). Shoqëria shpërndahet në formë riorganizimi ose likuidimi.

Afati i veprimtarisë së shoqërisë caktohet e pakufizuar duke filluar nga viti 2023 si viti i parë i veprimtarisë.

#### Neni 22

### Kur shoqëria likuidohet

Asambleja e ortakëve emëron likuidatorin, të cilit i paraqitet bilanci dhe shoqëria i jep fund veprimtarisë së saj në castin e miratimit të këtij raporti të hartuar.

Pasuritë që janë vënë në dispozicion të shoqërisë me të drejtë shfrytëzimi shiten në vartësi të shkallës së konsumit të tyre. Të ardhurat ndahen ndërmjet ortakëve në përpjestim me kuotën e vënë. Mjetet financiare të fituara si rezultat i veprimtarisë së shoqërisë e të filialeve të saj dhe fondet financiare ndahen ndërmjet ortakëve në përpjesetim me kuotat e vëna pasi të jenë bërë pagesat për kreditorët.

#### Neni 23

Kur pushon veprimtaria e një filiali, për efekt të riorganizimit të tij, afatet e pushimit caktohen nga Asambleja e Ortakëve. Likuidimi i filialeve bëhet njëjloj si për shoqërinë. Mjetet financiare të fituara si rezultat i veprimtarisë së filialit të likuiduara dhe fondet e tij financiare vihen në dispozicion të shoqërisë pasi t'u jenë bërë pagesat likuidatorëve.

#### Neni 24

### Hyrja në fuqi

Ky statut është i hartuar në dy kopje në gjuhën shqipe dhe hyn në fuqi me miratimin dhe pranimin e depozitimit të tij pranë Regjistrimit Tregtar.

Tiranë më 06/04/2023

**ORTAKU THEMELUES I SHOQËRISË**

**ELVIS PEÇI**

